

# disa fakte:

- Në të gjithë botën, 650 ,milion vajza që jetojnë janë martuar 18 vjeç
- Numri I vajzave të martuara në fëmijëri është rreth 12 million në vit.
- Azia e veriut - 40 % (285 milion ose 44 % të totalit global),
- Afrika – 18% (115 milion ose 18%).
- Kjo praktikë ka rënie në botë, në dekadën e fundit ka rënë me 15%, - duke parandaluar rreth 25 milion martesë të hershme. Duke rritur mundësitë e edukimit si edhe investimeve në arsim e edukim e parandalimit

1. Martesa e fëmijëve ndodh edhe në vendet me të ardhura të larta. Në Shtetet e Bashkuara, shumica e të gjitha 50 shteteve kanë një përjashtim në ligj që lejon fëmijët të martohen para moshës 18 vjeç.
2. Që nga viti 2017, në Bashkimin Evropian, vetëm katër vende nuk tolerojnë përjashtime nga mosha minimale prej 18 vjeç për martesë.
3. Martesa në fëmijëri ka pasoja në shumë fusha të jetës së një vajze. Për shembull, në Etiopi, shumica e grave të reja që u martuan në fëmijëri lindën përpara moshës 20 vjeç dhe nuset-fëmijë ishin më pak të prirura për të marrë kujdes të specializuar gjatë shtatzënisë dhe lindjes së fundit. Përveç kësaj, vajzat adoleshente të martuara në Etiopi kanë tre herë më shumë gjasa të lënë shkollën kundrejt bashkëmoshatareve të pamartuara herët.

**UNICEF is working to end child marriage in 64 countries globally**

**#EndChildMarriage**



# Përse ndodh?

- Shkaqet e martesës së fëmijëve janë komplekse dhe të ndryshme. Ajo është e motivuar nga faktorë të ndryshëm nëpër komunitete dhe rajone - ndonjëherë edhe brenda të njëjtit vend. Në masë dërrmuese, kjo ndodh nëkombet më të varfëra të botës.
- Përveç varfërisë, ruajtja e nderit të familjes ose sigurimi i "mbrojtjes" për familjen, normat dhe zakonet shoqërore dhe besimet fetare mund të ndikojnë në detyrimin e fëmijëve për martesë.

# Ku ndodh më shpesh?

- Ky është një problem global. Kalon përtej kufijve etnikë, kulturorë, fetarë e ndodh kudo – nga Afrika në Azi – Europë e USA
- Në afrikën perqmdimore, Nigeria ruan shkallën më të lartë të martesave të fëmijëve para moshës 18 vjeç.

# Si lidhet varfëria me martesën e detyrueshme?

- Për prindërit me disa fëmijë ose familje që jetojnë në varfëri ekstreme, martesë e fëmijëve është thjesht një mënyrë për të ndihmuar në zbutjen e situatës së tyre të dëshpëruar ekonomike. Në komunitetet ku familja e një vajze paguan një prikë, martesë në një moshë më të re mund të nënkuptojë një shpenzim më të ulët.
- Në komunitetet e tjera, transaksioni ekonomik është i kundërt dhe një burrë do t'u paguajë një çmim nuses prindërve të një vajze për t'u martuar me të. Në këto komunitete, vajzat më të reja shpesh marrin një çmim më të lartë, pasi ato me sa duket kanë më shumë kohë për t'iu kushtuar familjes së tyre të re dhe për të lindur më shumë fëmijë.
- Vajzat ndonjëherë martohen për të ndihmuar në kompensimin e borxheve, për të zgjidhur konfliktet ose për të sjellë para kur familjet janë në vështirësi financiare. Në përgjithësi, martesë e fëmijëve krijon shumë stimuj ekonomikë për prindërit që të martojnë vajzat e tyre të vogla – qoftë për siguri financiare apo përfitime. Mjerisht, praktika gjithashtu tenton të fusë në kurth vajzat dhe fëmijët e tyre në disavantazh ekonomik gjatë gjithë jetës.
- Ndërsa varfëria është një shkak kryesor i martesës së fëmijëve, ajo është gjithashtu një pasojë e vazhdueshme. Të Duke iu hequr shansi për t'u rritur, për të mësuar dhe për të realizuar plotësisht potencialin e tyre, nuset-fëmijë janë të pafuqishme, veçanërisht në vendet me resurse të ulta ekonomike. Pa arsim, gratë që janë martuar herët, nuk mund t'i japin fund ciklit të varfërisë për veten ose familjen e tyre.

# Përse është e dëmshme? Pasojat..

- Martesa e hershme ka efekte të mëdha në shëndetin fizik dhe mendor të vajzave dhe në mundësitë për të ardhmen. Vajzat që martohen herët kanë më pak gjasa të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Ata përballen me ndarjen nga familja dhe miqtë gjatë një faze kritike të jetës së tyre. Ata pritet të marrin rolin e një gruaje të rritur – të drejtojnë një familje dhe të rrisin një familje – në vend që të shkojnë në shkollë dhe të marrin pjesë në aktivitete të shëndetshme shoqërore dhe lojëra të përshtatshme për moshën. Një nuse fëmijë zakonisht nuk mund të zgjedhë vetë për të ardhmen e saj.
- Ndikon ndjeshëm në aftësinë e një vajze për të vazhduar arsimimin. Shumë vajza detyrohen të braktisin shkollën për t'u fokusuar në përgjegjësitë shtëpiake ose për të rritur fëmijë. Prindërit dhe drejtuesit e komunitetit mund të mos e shohin vlerën në vazhdimin e edukimit të një vajze, duke e parë atë si të panevojshme për rolet e saj kryesore në jetë si grua dhe nënë.
- Martesat e fëmijëve kanë pasoja shkatërruese në shëndetin dhe zhvillimin e vajzave. Si vetë fëmijë, ato nuk janë të përgatitura fizikisht dhe emocionalisht për t'u bërë nëna. Nënata adoleshente dhe foshnjat e tyre janë të dyja në një rrezik më të lartë për të vdekur gjatë lindjes sesa gratë që kanë fëmijë më vonë. Në fakt, komplikimet në shtatzëni dhe lindje janë ndër shkaqet kryesore të vdekjes globalisht tek vajzat adoleshente të moshës 15 deri në 19 vjeç.
- Vajzat e reja gjithashtu mund të mos e kuptojnë plotësisht shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues dhe mund të kenë vështirësi në aksesin e informacionit për kontracepsionin dhe planifikimin familjar. Ata gjithashtu kanë më shumë gjasa të përjetojnë dhunë në familje ose shfrytëzim, madje edhe brenda martesës.
- Risk të shfrytëzimit dhe abuzimit ekonomik, pasi atyre u mungojnë avantazhet e plota të njohjes personale e sociale,.

# Lidhja e edukimit me reduktimin e martesave të hershme?

- Vajzat të cilat nuk kanë marrë edukim të përshtatshëm kanë më shumë gjasa të martohen nën moshën 18 vjeç.
- Shkollimi – dija
- Identiteti – Kush jam unë?
- Modelet sociale kundrejt Izolimit
- Edukimi – Dije dhe vetkonfidencë për vendimet jetësore



# Edukata seksuale dhe edukimi për barazinë gjinore në sistemin arsimor në Shqipëri

- Prindërit dhe familja luajnë një rol kyç në formimin e mënyrës se si ne i kuptojmë identitetet tona seksuale dhe shoqërore. Prindërit duhet të jenë të aftë t'u adresojnë fëmijëve aspektet fizike dhe të sjelljes të seksualitetit njerëzor si dhe fëmijët duhet të jenë të informuar dhe të pajisur me njohuritë dhe aftësitë për të marrë vendime të përgjegjshme rreth seksualitetit, marrëdhënieve, HIV-it dhe sëmundjeve të tjera seksualisht të transmetueshme.
- Sot, shumë të rinj nuk marrin përgatitjen e duhur për jetën e tyre seksuale. Kjo i bën ata më të prirur ndaj sforcimeve në zgjedhjen e partnerit, apo pre e dhunimit dhe shfrytëzimit, shtatëzanive të padëshiruara dhe sëmundjeve seksualisht të transmetueshme (SST)



# Konteksti Shkollor

- Është e domosdoshme *përfshirja e edukimit seksual gjithëpërfshirës* nëpërmjet zbatimit të programeve mësimore.
- **UNFPA, MASH dhe AGJENCIA E SIGURIMIT TE CILESISE SE ARSIMIT PARAUNIVERSITAR** kanë konceptuar një ndërhyrje multidimensionale në sistemin arsimor me qëllim pajisjen e mësuesit me qëndrimet, njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të planifikuar dhe për të lehtësuar mësimdhënien e edukimit seksual në shkollë.

# Konteksti historik mbi tentativat e hershme për ta institucionalizuar edukatën seksuale në sistemin arsimor në Shqipëri

- Edukimi shëndetësor-seksual si dimension shkollimi u bë pjesë e sistemit arsimor shqiptar në vitet 1995 deri në vitin 2005.
- Ky dimension shkollimi u shtri në klasat e treta të ciklit të ulet si pjesë e lëndës “Dituri Natyre” dhe në klasat 5-8, si lëndë më vete.
- *Në vitet që pasuan edukimit shëndetësor/seksual iu bashkëngjit dhe dimension i aftësisë për jetën, ku mori zhvillim dhe sjellja seksuale, seksualiteti, pasojat e sjelljes seksuale jo të shëndetshme, sëmundjet seksualisht të transmetueshme, repertori sjellor me bazë formim seksual, etj.*

# PROCESI I INSTALIMIT TE EDUKIMIT SHENDETESOR/SEKSUAL

- **Paradoksal**, sepse ky dimension edukimi merrte jetë në kushtet kur vetë stafi mësimor kishte të mbartura problematika që lidheshin me formimin e tyre të munguar, problematik dhe barriera socio-kulturore në aspektin e edukimit seksual.
- **Dilematik**, pasi, institucionet që kishin identifikuar nevojën për të bërë pjesë të sistemit edukimin shëndetësor/seksual, ballafaqoheshin me kundër-argumente dhe barriera që vinin nga faktorë të tjerë të interesuar për shkollën. Shkolla dhe faktorë të caktuar relativisht nuk ishin të gatshëm të përmbushin cilësisht edukimin shëndetësor/seksual. Tabutë e kanë shoqëruar këtë proces.

Edukimi seksual shënjon fillimin e dimensionit të edukimit **“kuptimi për veten”** dhe i jep relativisht përgjigje pyetjeve që lidhen me identitetin sidomos në moshën e pubertetit...

---

*Në çfarë mase, ekspertët e edukimit janë të gatshëm profesionalisht, etiketisht, metodologjikisht të përmbushin qëllimet e këtij dimensionit edukimi...?*

# Pse shkolla?

- *Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim formimin e çdo individi, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes, të jetë i përgjegjshëm për familjen, shoqërinë e kombit etj...*

Sistemi arsimor parauniversitar ka

- 1 Cikli i shkollimit kur fillon edukimi seksual
- 2 Kurrikula shkollore, hapesira që i le edukimit seksual
- 3 Formimi profesional i mesuesit që permbush edukimin



- Shkollat si institucione *kanë detyrim ligjor* të udhëheqin të rinjtë drejt maturimit social dhe pjekurisë seksuale si sjellje individuale sociale;
- Shkolla si institucion punon me *personel të trajnuar* për të udhëhequr dimensionin e edukimit seksual;
- Shkolla si institucion social udhëheq proceset e edukimit seksual referuar nevojave fiziologjike të grup-moshës, duke *theksuar pikat kritike ku ndodh zhvillimi fiziologjik* i tyre;
- Shkollat si institucione sociale njëkohësisht janë shumëfishues të politikave efektive *që shpërndajnë efektin në* familje për edukimin shëndetësor.
- Shkollat si institucione sociale *mund të jenë ura komunikimi me komunitetin* nëpërmjet projekteve të ndryshme ose nëpërmjet komuniteteve ndërsektorale lokale;

- 1.Në arsimin fillor**, edukimi seksual, nis me lëndën e diturisë së natyrës (në tematikat që i përkasin biologjisë). Përmes kësaj lënde nxënësit mësojnë rreth cikleve jetësore të njeriut dhe kafshëve, përfshirë riprodhimin. Ata nisin të kuptojnë konceptet e riprodhimit dhe rritjes, por jo se si ndodh riprodhimi.
- 2.Edukimi seksual i trajtuar përmes kurrikulës zyrtare të biologjisë** formëson edukimin seksual në aspekte që lidhen me zhvillimin e trupit në grup moshë të caktuar, organet riprodhuese, pjekurinë seksuale dhe nevojat fiziologjike të grup-moshës, duke nënvizuar pikat kritike, ku ndodh zhvillimi fiziologjik i tyre.
- 3.Edukimi seksual i trajtuar përmes kurrikulës zyrtare të edukimit fizik, sportit dhe shëndetit** zhvillon fusha të përmbajtjes që lidhen me veçoritë njohëse, psikologjike e sociale të të rinjtë. Tematika “Edukim në shërbim të komunitetit, mirëqenies dhe shëndetit”, u mundëson nxënësit fitimin e kompetencave për ruajtjen dhe kultivimin e shëndetit të tyre dhe të tjerëve. Nëpërmjet njohurive të kësaj tematike nxënësit u mundësohet njohja me konceptin e identitetit gjinor dhe vlerave identifikuese sipas përkatësisë gjinore.
- 4.Edukimi seksual përmes kurrikulës zyrtare të qytetarisë** -merr përsipër të trajtojë çështje nisur nga perspektiva e zhvillimit personal, social dhe repertorit sjellor. Në programin e qytetarisë, tematikat "Individët, grupet, shoqëria" dhe "Shëndeti" pikëpëriten me fusha të përmbajtjes së edukimit seksual. Njohuritë për secilën tematikë që paraqiten më poshtë cilësohen nga ekspertët si të domosdoshme për të fituar ndryshime për sjellje të shëndetshme.

# Strategjitë shkollore për barazinë gjinore

- Rezulton se që nga viti 2015 – 2016 janë trajnuar 3000 mësues rreth çështjeve të edukimit shëndetësor dhe seksual.
- Gjatë vitit 2018 MASR dhe ASCAP certifikuan 648 mësues TOT
- Gjatë vitit 2019 janë zgjeruar kapacitetet trajnuese në 4 Drejtori Rajonale dhe 4 Zyra Arsimore ndërsa pritet të trajnohen rreth 3200 mësues në lidhje me çështjet e edukimit seksual.

- Shumë ndërhyrje janë realizuar përgjatë 25 viteve të fundit në Shqipëri për të përmirësuar edukimin seksual tek të rinjtë në mjedise të ndryshme jo-formale. Ndërhyrjet në këto mjedise synojnë, ndër të tjera, të arrijnë sa më shumë të rinj që nuk ndjekin shkollën ose që i përkasin grupeve të marginalizuara.
- Që nga fillimi i viteve 2000 në Shqipëri janë zhvilluar studime të ndryshme për të vlerësuar jo vetëm njohuritë, por edhe sjelljet seksuale të të rinjve shqiptarë. Ndërkohë që ka një përmirësim të ndjeshëm të njohurive mbi Shëndetin Seksual dhe Riprodhues, (ShSR), ende në Shqipëri, sjelljet seksuale të shëndetshme raportohen në nivele të ulëta.
- Sipas Studimit Demografik dhe Shëndetësor 2017/18, njohuritë e të rinjve për metodat moderne kontraceptive janë mjaft të mira, përafërsisht 96% për grupmoshën 15 – 24 vjec. Nga ana tjetër, niveli i përdorimit të këtyre metodave është mjaft i ulët. Po të përqëndrohemi te përdorimi i prezervativit, vetëm 1.7% e të rinjve të moshës 15-24 vjeç e përdorin atë, duke na paraqitur kështu një prevalencë shumë të ulët të përdorimit të tij. Këto rezultate sugjerojnë nevojën urgjente për të punuar më shumë me të rinjtë, brenda dhe jashtë shkolle në fushën e shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese.



- Në vitin 2003 në dy rrethe të Shqipërisë, Tiranë dhe Vlorë, UNICEF mbështeti dizenjimin e një modeli të ri të shërbimeve shëndetësore miqësore për të rinjtë, i integruar në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor.
- Modeli synonte të përditësonte shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor me protokollet dhe shërbimet e reja që janë sensitive për moshën dhe gjininë dhe që janë të përshtatshme për nevojat e adoleshentëve dhe të rinjve.
- Modulet e hartuara për trajnim u testuan nga stafi i këtyre qendrave.
- Modeli u përfshi në strategjinë e parë kombëtare për rininë në vitin 2015.
- Ky model u mbështet nga UNICEF për periudhën 2003 – 2006 dhe u supervizua edhe për dy vjet të tjera.
- Shërbimet miqësore për të rinjtë kanë vazhduar të ofrohen kryesisht përmes OJQ-ve

- Edukimi seksual midis grupeve vulnerabël ka qenë një sfidë e rëndësishme në Shqipëri. Për shkak të marginalizimit të tyre, shpesh herë ka qenë me e vështirë arritja e këtyre grupeve. Dy programet e Fondit Global (2007-2011 and 2018-2019) kanë adresuar në mënyrë të veçantë nevojat e këtyre grupeve dhe kanë synuar fuqizimin e tyre në aspektin e njohurive dhe sjelljeve të shëndetshme, të cilat reduktojnë mundësitë për t'u infektuar me HIV. Edukimi seksual ka qenë pjesë e këtyre ndërhyrjeve. Mbetet sfidë vazhdimi i këtyre ndërhyrjeve edhe pas përfundimit të raundit të dytë të Programit të Fondit Global në Shqipëri.
- Vlen të thejsohet edhe roli i disa OJQ, si STOP AIDS dhe Aksion + në arritjen me informacion dhe shërbime përsa i përket grupeve më të riskuara të të rinjve nga HIV dhe AIDS si dhe grupeve me vulnerabël të të rinjve.
- Promovimi i ESGJ ka hasur në shumë sfida në Shqipëri. Ende ka rezistencë nga prindërit dhe kujdestarët, anëtarët e komunitetit, sikurse dhe nga mësuesit, të cilët e shohin edukimin seksual si një faktor që i çon të rinjtë drejt marrëdhënieve seksuale të hershme. Ata argumentojnë se kjo gjë është kundër kulturës shqiptare, se shkollat duhet të promovojnë vlera në vend të edukimit seksual, se edukimi seksual mund të jetë i nevojshëm për të rinjtë, por jo për fëmijët në moshë të vogël.

# Vijim..

- Programe kombëtare ekzistuese mbi ESGJ, duke u fokusuar si në përmirësimin e programeve të bazuara në shkollë, ashtu edhe në qasjet komunitare, ku përfshirja e të rinjve është thelbësore.
- Financimi i duhur i ESGJ, duke përfshirë edhe trajnimin e mësuesve.
- Financimi i duhur i aktiviteteve për Informim, Edukim dhe Komunikim (IEK) për promovimin e shëndetit, të cilat mbështesin dhe synojnë komunikimin për ndryshimin e sjelljes për një ndryshim pozitiv shoqëror.
- Përshkallëzimi në nivel kombëtar i shërbimeve shëndetësore miqësore për të rinjtë, të cilat do të eliminojnë barrierat në komunikim mbi çështje të lidhura me shëndetin seksual dhe riprodhues midis të rinjve.
- Reflektimi në nivel lokal i integritit të shëndetësisë dhe punës sociale, nëpërmjet një përfshirjeje më të mirë të institucioneve respektive locale, duke përfshirë komunitetet dhe bashkitë.
- Zgjerimi i mbështetjes për organizata dhe institucione që sigurojnë dhe ofrojnë kujdes për shëndetin seksual dhe riprodhues në Shqipëri.
- Shoqërimi i ndërhyrjeve të ESGJ me sensibilizim të komuniteteve, veçanërisht të prindërve, që synojnë ndryshimin e normave sociale rreth seksualitetit dhe ESGJ dhe sigurojnë hapësirë për të rinjtë që të ndikojnë dhe të kërkojnë të drejtat e tyre.

# Strategjitë për barazinë Gjinore

## **BARAZIA GJINORE DHE MOS DISKRIMINIMI**



Të drejtat e njeriut janë universale.

Ato u përkasin të gjithë individëve dhe duhet të gëzohen në mënyrë të barabartë nga të gjithë.

Pavarësisht kësaj, në shoqëri janë të pranishme sjellje që trajtojnë në mënyrë të diferencuar individë dhe kjo për shkaqe nga më të ndryshmet një prej të cilave është edhe përkatësia gjinore.

Çdo trajtim jo i barabartë i një individ në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta apo të ngjashme konsiderohet diskriminim

## BARAZIA GJNORE



Për shkaqe të ndryshme dhe të natyrshme historike, tradicionale, zakonore, diskriminimi gjinor nuk sulmon vetem grate te cilat jane viktime te drejteperdrejta, por edhe femijet.

Në vendin tonë ka egzistuar zakoni që kur lindte një vajzë prindërit hidhëroheshin, sepse djali për ta përfaqësonte trashigimninë e tyre.

Djalin ata e prisnin me gëzim dhe festime, vajzën me hidhërim.

Nëna e cila është diskriminuar vazhdimisht nga burri i saj kurrë nuk ka protestuar ndaj kësaj gjëje.

Me këtë ajo i jep mesazhin vajzes së saj se burrat duhen duruar.

Kurse djemtë marrin mesazhin se kanë të drejtë të ushtrojnë superioritetet dhe pushtet vetëm sepse janë meshkuj.



# BARAZIA GJINORE

Statusi i mashkullit është shumë dominant si në familje dhe në shoqëri.

Kurse gruaja konsiderohet si pronë ekskluzive e burrit.

Gruaja konsiderohet si diçka shtëpiake që duhet mbajtur dhe çdo gjë që ka nevojë, si ushqimin, veshmbathjen, të mbajturën në shtëpi, duhet tja kërkojë mashkullit për ti siguruar


Në shoqërinë tonë ka edhe shumë keqkuptime dogmatike të cilat rrisin diskriminimin gjinor.

Shumë persona kritikojnë veshjet e zbërthyera, të hapura e të holla, grimimin e fytyres, fundin e shkurtër etj.

Këto ideologjira e kanë bërë gjithmonë femrën ti nënshtrohet dominimit mashkullor.

Arsimimi jo i mjaftueshëm i femrave, apo ambicjet shumë të ulëta të tyre bëjnë që ato të mbeten të varura ekonomikisht prej burrit.

Ne atë kohë ku të drejta të barabarta dhe ndarja e detyrave që kryejnë në mënyrë të rëndësishme në familje, në rrethin shoqëror apo atë të punësuar atëherë duhet të kuptojmë se barazia gjinore



## Çfarë është Barazi Gjinore?



Barazia gjinore arrihet kur gratë dhe burrat gëzojnë të njëjtat të drejta dhe mundësi nëpër të gjithë sektorët e shoqërisë, duke përfshirë pjesëmarrjen ekonomike dhe vendim-marrje, dhe kur sjelljet e ndryshme, aspiratat dhe nevojat e grave dhe burrave janë vlerësuar në mënyrë të barabartë dhe të favorizuar.

# Edukimi për Barazinë Gjinore- kyç për parandalimin e martesave të hershme

- **Normat e martesave të hershme:** Në Shqipëri, rreth 10% e vajzave martohen para moshës 18 vjeçare. Ky fenomen është më i përhapur në zonat rurale dhe në komunitetet me më pak mundësi ekonomike dhe arsimore.
- **Arsimimi i vajzave:** Edukimi është një nga faktorët më të rëndësishëm për parandalimin e martesave të hershme. Vajzat që ndjekin shkollën kanë më pak gjasa të martohen herët. Në Shqipëri, pjesëmarrja e vajzave në arsimin e mesëm është relativisht e lartë, por ende ka sfida, sidomos në zonat rurale dhe në komunitetet e marginalizuara.
- **Punësimi dhe Pavarësia Ekonomike:** Rritja e mundësive për punësim dhe pavarësia ekonomike për gratë janë kyçe për përmirësimin e barazisë gjinore. Sipas INSTAT, pjesëmarrja e grave në tregun e punës është rreth 52%, ndërsa për burrat është rreth 70%. Kjo pabarazi ekonomike mund të ndikojë në presionin për martesa të hershme.
- **Roli i Normave Sociale:** Normat dhe stereotipet gjinore luajnë një rol të rëndësishëm në vendimet për martesë të hershme. Në shumë komunitete, PRITET që vajzat të martohen dhe të kenë fëmijë në një moshë të re, çka ndikon negativisht në mundësitë e tyre për arsimim dhe zhvillim personal.



# EBGJ ka rëndësi për parandalimin e martesave të hershme

## 1. Arsimimi i Vajzave

- **Qasje më e mirë në arsim:** Barazia gjinore siguron që vajzat kanë të njëjtat mundësi arsimimi si djemtë. Vajzat që shkojnë në shkollë kanë më pak gjasa të martohen herët, pasi arsimimi i ofron njohuri, aftësi dhe mundësi për të ardhmen.
- **Ndërgjegjësimi për të drejtat:** Arsimimi i bën vajzat më të ndërgjegjshme për të drejtat e tyre dhe u jep atyre mjetet për të sfiduar normat dhe praktikat diskriminuese.

## 2. Pavarësia Ekonomike

- **Punësimi dhe pavarësia financiare:** Kur gratë kanë mundësi të barabarta për punësim dhe fitim, ato bëhen më të pavarura financiarisht. Kjo pavarësi redukton presionin ekonomik për t'u martuar herët.
- **Akses në burime dhe prona:** Barazia gjinore siguron që gratë kanë të njëjtin akses në burime dhe prona si burrat, duke u dhënë atyre më shumë kontrollë mbi jetën e tyre

# 3. Shëndeti dhe Mirëqenia

- **Shërbimet shëndetësore:** Barazia gjinore përmirëson qasjen në shërbimet shëndetësore, përfshirë kujdesin riprodhues dhe për planifikimin familjar. Kjo mund të ndihmojë në parandalimin e shtatzënive të hershme dhe komplikacioneve shëndetësore që lidhen me to.
- **Reduktimi i dhunës:** Një shoqëri që promovon barazinë gjinore ka më pak tolerancë për dhunën ndaj grave dhe vajzave, përfshirë detyrimin për martesë të hershme.

# 4. Ndryshimi i Normave Sociale dhe Stereotipeve

- **Krijimi i modeleve pozitive:** Kur gratë dhe vajzat kanë mundësi të barabarta dhe janë të suksesshme në fusha të ndryshme, ato shërbejnë si modele pozitive për brezat e ardhshëm.
- **Rritja e pritshmërive:** Barazia gjinore ndihmon në ndryshimin e pritshmërive sociale dhe stereotipeve që e shohin martesën e hershme si normale apo të dëshirueshme.

# 5. Forcimi i Ligjeve dhe Politikave

- **Politika dhe legjislacioni mbrojtës:** Përmirësimi i barazisë gjinore shpesh shoqërohet me politika dhe legjislacion më të fortë për mbrojtjen e të drejtave të vajzave dhe grave, përfshirë ligje që ndalojnë martesat e hershme.
- EBGJ merr rëndësi të veçantë për krijimin e një shoqërie ku vajzat dhe gratë kanë mundësitë dhe liritë e nevojshme për të zgjedhur rrugën e jetës së tyre. Ajo ndihmon në ndërtimin e një mjedisi ku martesat e hershme nuk janë të nevojshme, duke ofruar alternativa të sigurta dhe të qëndrueshme për zhvillimin personal dhe profesional të vajzave.

# Vendet Europiane

- BE përdor Indeksin e Barazisë Gjinore për të matur progresin në këtë fushë. Sipas raportit të fundit të Institutit Evropian për Barazinë Gjinore (EIGE), Suedia, Danimarka dhe Franca kanë nivelin më të lartë të barazisë gjinore në BE.
- **Diferenca e Pagave:** Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme, diferenca e pagave mes burrave dhe grave mbetet një problem në BE. Mesatarisht, gratë fitojnë rreth 14% më pak se burrat për të njëjtën punë. Kjo diferencë varion nga një vend në tjetrin, duke qenë më e ulët në Rumani dhe më e lartë në Estoni.
- **Pjesëmarrja në Tregun e Punës:** Gratë përbëjnë një pjesë të rëndësishme të forcës punëtore në BE, por ato ende kanë më pak gjasa të jenë në pozita drejtuese. Vetëm rreth 30% e menaxherëve në BE janë gra. Për të përmirësuar këtë situatë, disa vende kanë vendosur kuota gjinore për borde drejtuese.
- **Dhuna ndaj Grave:** Dhuna ndaj grave mbetet një problem serioz në BE. Sipas të dhënave të Agjencisë së BE-së për të Drejtat Themelore, një në tre gra në BE ka përjetuar dhunë fizike ose seksuale që nga moshën 15 vjeç. BE ka ndërmarrë disa iniciativa për të luftuar këtë fenomen, përfshirë Strategjinë e re për Barazinë Gjinore 2020-2025.

# Barazia Seksuale në BE

- **Të Drejtat LGBTIQ+:** BE është lider global në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave LGBTIQ+. Shumica e vendeve të BE-së kanë legjislacion që ndalon diskriminimin bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor.
- **Martesa dhe Bashkëjetesa e të njëjtit Seks:** 16 vende anëtare të BE-së lejojnë martesën mes personave të të njëjtit seks, ndërsa disa të tjera lejojnë bashkëjetesën civile ose partneritetet e regjistruara. Megjithatë, disa vende, si Polonia dhe Hungaria, kanë qasje më konservative ndaj të drejtave LGBTIQ+.
- **Akses në Shërbime Shëndetësore:** Personat LGBTIQ+ në BE kanë të drejtë për akses të barabartë në shërbimet shëndetësore, përfshirë kujdesin riprodhues dhe shëndetin mendor. Disa vende kanë bërë përparime të rëndësishme në sigurimin e këtyre shërbimeve, por mbeten sfida, sidomos në pjesët më konservative të BE-së.

# Rëndësia e Barazisë Gjinore për Parandalimin e Martesave të Hershme

- **Edukimi dhe Ndërgjegjësimi:** Promovimi i barazisë gjinore dhe seksuale ndihmon në edukimin dhe ndërgjegjësimin e shoqërisë për të drejtat dhe mundësitë e barabarta, duke zvogëluar presionin për martesat e hershme.
- **Mbështetja për Vajzat dhe Gratë:** Politikat që promovojnë barazinë gjinore dhe seksuale ofrojnë mbështetje dhe mundësi për vajzat dhe gratë, duke përfshirë akses më të mirë në arsim, shëndetësi dhe tregun e punës.
- **Ndryshimi i Normave Sociale:** Barazia gjinore dhe seksuale ndihmojnë në ndryshimin e normave dhe stereotipeve tradicionale që mund të mbështesin martesat e hershme dhe diskriminimin.
- Ndërhyrjet për përmirësimin e barazisë gjinore dhe seksuale kërkojnë një qasje të gjithanshme që përfshin edukimin, mbështetjen ekonomike dhe sociale, legjislacionin dhe politikat, si dhe ndryshimin e normave sociale dhe kulturore. Duke punuar në këto fusha, mund të krijohet një mjedis më i drejtë dhe gjithëpërfshirës që ndihmon në parandalimin e martesave të hershme dhe përmirësimin e mirëqenies së vajzave dhe grave.